REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim,
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

Nr.prot:05/1003 Datë 13.10.2026

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Personelit Edukativo-Arsimor, përkatësisht nenit 11, paragrafi 2, Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime nxjerr këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E KONKURSIT PËR ANGAZHIM ME AFAT TË CAKTUAR – ZËVENDËSIM

I. Anulohet konkursi me kod të publikuar **RPC0014057** dhe referencë **RN00020518**, për pozitën mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë Shqipe, me afat të caktuar – zëvendësim, i publikuar më 02.10.2026, me referencë të rekrutimit nr. 02-111/01-0021193/26.

II. Anulimi bëhet për shkak se, pas verifikimit të listave përkatëse të kandidatëve, është konstatuar se ekzistojnë kushtet për përzgjedhjen e një kandidati të përshtatshëm nga lista e kandidatëve fitues e formuar pas përfundimit të konkursit të rregullt, në përputhje me rendin e përzgjedhjes të përcaktuar në nenin 11, paragrafi 2, të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024.

III. Drejtoria Komunale të Arsimit, obligohet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për përzgjedhjen dhe angazhimin e kandidatit të përshtatshëm për zëvendësim, duke respektuar rendin e përzgjedhjes, kriteret dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr. 19/2024.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime, më 02.10.2026, ka publikuar konkursin me kod RPC0014057 dhe referencë RN00020518, me referencë të rekrutimit nr. 02-111/01-0021193/26, për pozitën mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë Shqipe, me afat të caktuar – zëvendësim. Gjatë shqyrtimit të mënyrës së plotësimit të kësaj pozite, është konstatuar se ekziston lista e kandidatëve fitues e formuar pas përfundimit të konkursit të rregullt për pozitën e mësimdhënësit/es së Gjuhës Shqipe dhe se ekzistojnë kushtet për përzgjedhjen e një kandidati të përshtatshëm nga kjo listë.

Neni 11, paragrafi 2, i Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 përcakton mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për angazhim me afat të caktuar, duke paraparë shfrytëzimin e listave përkatëse të kandidatëve, përfshirë listën e kandidatëve fitues të formuar pas përfundimit të konkursit të rregullt. Konkursi i veçantë për angazhim me afat të caktuar shpallet kur nuk ka kandidatë të përshtatshëm në listat e përcaktuara me këtë dispozitë.

Meqenëse, në rastin konkret, janë konstatuar kushtet për përzgjedhjen e kandidatit të përshtatshëm nga lista përkatëse, Drejtoria Komunale e Arsimit vlerëson se plotësimi i pozitës duhet të bëhet përmes procedurës së paraparë në nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024. Për këtë arsye, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim,
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë brenda afatit 15 ditor , pranë Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Sektorit e Arsimit nëpërmjet Drejtorisë Komunale të Arsimit në Shtime. Paraqitja e ankesës nuk e pezullon ekzekutimin e këtij vendimi.

Një kopje i dorëzohet:

Njësisë për Burime Njerëzore

Udhehqeës i sektorit të arsimit

Lulzim Sahiti

Adresa: Rr. Tiranës, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
Tel.: +381290389016, email: info@shtime-komuna.org
http://kk.rks-gov.net/shtime